

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18, dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24) dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe Shoqëria Aksionare në pronësi private ASNOVA HOLDING, me seli në rrugën Hetman Kirilo Rozumovkij nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, dorëzuar përmes avokatit Maja Pargovska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.11.2024, mori këtë

AKTVENDIM

Konstatohet se përqendrimi me të cilin ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe Shoqëria Aksionare në pronësi private ASNOVA HOLDING, me seli në rrugën Hetman Kirilo Rozumovkij nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, indirekt, përmes Shoqërisë Aksionare në pronësi private SAV 92, me seli në rrugën Hetman Kirilo Rozumovkij nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët mbi SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ORBIKO UKRAINË, me seli në rr. Georgi Toropovski ndërtesa 2, 02100 Kiev, Ukrainë, nëpërmjet blerjes së aksioneve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, më 30.10.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) ka pranuar një njoftim për përqendrim nga ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë dhe Shoqëria Aksionare në pronësi private ASNOVA HOLDING, me seli në rrugën Hetman Kirilo Rozumovkij nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, me të cilin ORBIKO SH.P.K. për tregti Zagreb dhe Shoqëria Aksionare në pronësi private ASNOVA HOLDING, indirekt, përmes Shoqërisë Aksionare në pronësi private SAV 92, me seli në rrugën Hetman Kirilo Rozumovkij nr. 27, Kiev, 03115, Ukrainë, synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët mbi

SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ORBIKO UKRAINË, me seli në rr. Georgi Toropovski ndërtesa 2, 02100 Kiev, Ukrainë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e marrjes së tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb ka si objekt veprimtarie - tregtinë. Në fakt, ORBIKO SHPK për tregti Zagreb është një shoqëri që merret kryesisht me tregtinë me shumicë dhe njëkohësisht është përfaqësues dhe shpërndarës në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh markash që variojnë nga produkte për kujdesin dhe bukurinë, produkte ushqimore dhe jo-ushqimore, pajisje teknike dhe elektrike, ilaçe, lodra, tekstile, cigare, vajra motorike dhe shumë produkte të tjera. Partnerët më të mëdhenj të ORBIKO SHPK për tregti Zagreb, produktet e të cilëve përbëjnë pjesën më të madhe të qarkullimit të ORBIKO SHPK për tregti Zagreb janë PHILIP MORRIS, PROCTER & GAMBLE, SHELL dhe S.C.JOHNSON ITALY S.r.l..

ORBIKO SHPK për tregti Zagreb është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë për tregti dhe shërbime **ORBIKO SHPK Shkup**, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Komuna e Kisela Vodës, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari prioritare: 46.90 tregti me shumicë e pa specializuar.

Objekti kryesor i veprimtarisë së ORBIKO SHPK Shkup është tregtia me shumicë e pa specializuar dhe njëkohësisht është përfaqësues dhe shpërndarës në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një numër të madh markash që variojnë nga: produkte ushqimore, vajra motorike, bateri, parfume, ujëra tualeti dhe deodorantë, kozmetikë dekorative, produkte për higjienë personale, produkte për kujdes dhe produkte për mirëmbajtjen e higjienës në shtëpi.

Shoqëria Aksionare në pronësi private "**ASNOVA HOLDING**", ka si objekt veprimtarie - veprimtari të tjera financiare-shërbyese, përveç sigurimit dhe fondeve pensionale, të papërmendura diku tjetër.

ASNOVA HOLDING nuk ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Shoqëria Aksionare në pronësi private "**SAV 92**", ka si objekt veprimtarie - tregti me shumicë e pa specializuar.

SAV 92 nuk ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ORBIKO UKRAINË ka si objekt veprimtarie - tregti me shumicë e preparateve parfumerie dhe kozmetike.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ORBIKO UKRAINË nuk ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por është pjesë e Grupit ORBIKO që në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i pranishëm përmes Shoqërisë për tregti dhe shërbime **ORBIKO SHPK Shkup**.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска